



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-043

Prishtinë, më 6 shtator 2018, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 6 SHTATOR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti, Slavko Simiq dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

Nga Ambasada Amerikane: Adem Gashi,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Zoja Nushi dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Çështjet vijuese: Vazhdimi i seancave të jashtëzakonshme,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës dhe
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Vazhdimi i seancave të jashtëzakonshme

Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, i njoftoi të pranishmit se seanca e jashtëzakonshme plenare, e thirrur me kërkesë të kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, e filluar më 4 dhe 5 shtator 2018, nuk ka përfunduar për mungesë të kuorumit, si dhe seanca e jashtëzakonshme plenare, e thirrur me kërkesë të 51 deputetëve të Kuvendit, përkundër dy përpjekjeve më 5 dhe 6 shtator 2018, nuk ka filluar për mungesë të kuorumit.

Për vazhdim e dy seancave të jashtëzakonshme, kryetari propozoi që të arrihet një marrëveshje me të gjitha grupet parlamentare dhe për këtë ai i propozoi tri opsione: Të dy çështjet e ngrehura të shqyrtohen dhe të votohen nga deputetët veç e veç. Rezultati i votimit të jetë i obligueshëm për të gjitha palët, në qoftë se e arrin numrin e votave; Të bashkëngjiten propozimet e të dyja palëve në një dokument të përbashkët që do të quhet Rezolutë e Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Rezoluta do t'i përmbante propozimet e opozitës dhe të pozitës. Ose një platformë dhe në të njëjtën kohë edhe për një grup të unitetit, të cilin duhet ta votojë Kuvendi i Republikës së Kosovës; Të propozohen dy rezoluta, njëra nga pozita e tjetra nga opozita dhe të votohen veç e veç.

Diskutimi i plotë i kryetarit është i dhënë në transkript.

Lidhur me propozimin e lartcekur të kryetarit diskutuan: Avdullah Hoti, kryetar i GP të LDK-së; Ahmet Isufi, kryetar i GP të AAK-së; Memli Krasniqi, kryetar i GP të PDK-së; Bilall Sherifi, kryetar i GP të Nismës Socialdemokrate; Glauk Konjufca, kryetar i GP të LVV-së, dhe Dardan Sejdiu, kryetar i GP të PSD-së; si dhe Xhavit Haliti dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, pasi nuk u arrit pëlqimi për caktimin e vazhdimit dhe mbajtjes së dy seancave të jashtëzakonshme plenare, kryetari i Kuvendit deklaroi se seanca e jashtëzakonshme, e kërkuar nga kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush

Haradinaj, po ashtu edhe seanca e jashtëzakonshme e kërkuar nga 51 deputetët të Kuvendit, do të thirret kur të arrihet kuorumi prej 61 deputetëve.
Diskutimi i plotë i kryetarit të Kuvendit është i dhënë në transkript.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës të papërfunduara nga seancat plenare të mëparshme të Sesionit pranveror dhe me pikat e reja që i plotësojnë kushtet për shqyrtim në seancë plenare.

Lidhur me përgatitjet për seancën plenare të radhës diskutuan: Xhavit Haliti dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Avdullah Hoti, kryetar i GP të LDK-së; Memli Krasniqi, kryetar i GP të PDK-së dhe Ahmet Isufi, kryetar i GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 13 shtator 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
- 4. Votimi i Raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017,*
- 5. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-010 për noterinë,*
- 6. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë,*
- 7. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian,*
- 8. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-094 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”,*
- 9. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-095 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS+” Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport,*
- 10. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-066 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferë,*
- 11. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,*
- 12. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120,*
- 13. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-069 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor,*

14. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-070 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor,*
15. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-071 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,*
16. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale,*
17. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme,*
18. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,*
19. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës,*
20. *Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur,*
21. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz,*
22. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike,*
23. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-038 për shërbimet postare,*
24. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,*
25. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,*
26. *Shqyrtimi i raportit vjetor i Autoritetit Rregullator për Ujëra për vitin 2017,*
27. *Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017,*
28. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017.*
29. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017,*
30. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017,*
31. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017,*
32. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017,*
33. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017,*
34. *Propozim-rezoluta e deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga shtatë (7) deputetë të GP të AAK-së, në lidhje me çështjen liberalizimi i vizave para dialogut,*
35. *Propozim-vendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Ndhimë Shtetërore,*
36. *Propozimi i grupeve parlamentare të AAK-së dhe Nismës Socialdemokrate për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,*
37. *Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit të RTK-së,*
38. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për (1) një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar,*
39. *Propozimi për zëvendësimin e dy (2) anëtarëve të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës,*
40. *Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga 7 deputetët nënshkrues nga GP i AAK-së, në lidhje me shtesat e fëmijëve.*

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

2. Procedimi i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së

3. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit

4. Procedimi i Projektligjit për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

5. Procedimi i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës

6. Procedimi i Projektligjit për referendum

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e projektligjeve të lartshënuara, nxori edhe këto përfundime:

1. P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës u shpërndalet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

2. P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së u shpërndalet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

3. P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit u shpërndalet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

4. P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

5. P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për Transmetuesin Publik të Kosovës u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

6. P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për Referendum u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

7. Kërkesa e Grupit të Miqësisë Kosovë-Kanada në Kuvendin e Kosovës për lejimin e vizitës zyrtare në Kanada

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e Grupit të Miqësisë Kosovë-Kanada në Kuvendin e Kosovës për lejimin e vizitës zyrtare në Kanada, prej 24 - 30 shtator 2018.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan: Xhavit Haliti dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari z. Veseli tha se do ta njoftojë parashtruesin e kërkesës në lidhje me propozimin e Kryesisë sa i përket përbërjes së këtij delegacioni dhe pastaj do të vendoset lidhur për këtë çështje.

8. Kërkesa e Furtuna Aliut për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Furtuna Aliu, nga Vushtrria, mbështetet financiarisht në shumën prej 4 950,00 euro për shkollimin e saj.

9. Kërkesa e z. Aziz Saliu për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Z. Aziz Salihu mbështetet financiarisht në shumën prej 2 500,00 euro për mbulimin e shpenzime të trajtimit shëndetësor të tij.

10. Kërkesa e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ-ja: Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës mbështetet financiarisht në shumën prej 2 600,00 euro për realizimin e aktiviteteve të tyre.

11. Kërkesa e zyrtarit të Administratës së Kuvendit, z. Mustafë Reçica, për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Zyrtari i Administratës së Kuvendit të Kosovës, z. Mustafë Reçica mbështetet financiarisht në shumën prej 3 000,00 euro për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor të tij.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 16:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale